



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 10548 /2023  
Data: 19.12. 2023

**PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET**

Nga mbledhja e njëmbëdhjetë -XI- për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 29.11.2023 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me Kryesuesit e dy Komiteteve Konsultative.
3. Takim me përfaqësuesit e Këshillave të Fshatrave.
4. Eventuale.

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## 2. Takim me Kryesuesit e dy Komiteteve Konsultative.

**Kryesuesi** thekson:- të njoftuar kanë qenë por siç e dini Qeveria ua ka ndaluar mëditjet për shkak të Ligjit të ri të pagave që është miratuar në Kuvendin e Kosovës. Sipas informatave që kam nga momenti që ua ka ndaluar mëditjet komitetet konsultative nuk kanë mbajtur mbledhje. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën në radhës të paraparë sipas agjendës.

## 3. Takim me përfaqësuesit e Këshillave të Fshatrave.

**Kryesuesi** thekson:- e njëjta çështje është edhe me këshillat e fshatrave sikur me komitete konsultative. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën në radhës të paraparë sipas agjendës.

## 5. Eventuale

**Kryesuesi** thekson:- duhet të hartohet plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024 për shkak se duhet të përcillet për kuvend.

**Resul Suma** thekson:- unë mendoj që këtë plan mundemi me lënë edhe për vitin 2024 por mundemi mi ndryshuar vetëm disa pika nëse janë të nevojshme për shkak se plani i punës për vitin 2023 ka qenë i mirë.

**Zaim Bela** thekson:- është mirë që me ftuar edhe drejtorin e QKMF-së në mënyrë që me qenë sa më të informuar.

**Kryesuesi** thekson:- sipas informatave që kam prej nxënësve ka arsimtarë që i thotë nxënësit idiotë, kali, budalla dhe nxënësi nuk i shkon në orë . Nxënësit pastaj sikur e kanë dëgjuar mësuesin ashtu siç ka thënë kanë filluar të njëjtat fjalë me ja thënë nxënësit që mendoj që nuk është mirë.

**Ajnure Thaçi** thekson:- ka arsimtarë që duanë me mbajtur orën siç duhet por nxënësit janë të pa edukuar dhe ka raste që edhe arsimarëve nuk u shkohet në orë për shkak se nxënësit po tregojnë edukatë jo të mirë.

**Kryesuesi** thekson:- është mirë që arsimtarët me pasur metodikën gjatë zhvillimit të procesit mësimorë, e jo me ju thënë nxënësve fjalë kërcënuese dhe fjalë fyese. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 14:55.

Procesmbajtësi

Ayni Bashi

